



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:000854

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05559490

**PKR.nr.115/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda**, në përbërje trupit gjykues prej Kryetarit të Trupit Gjykues – Gjykatësit **Drilon Haraçia** dhe gjykatësve profesional **Nikollë Komani dhe Ilir Rashkaj**- anëtar, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit A.D., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.1/2022, të datës 29.05.2021, tani përfaqësuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datë 15.11.2023, 19.12.2023, 09.02.2024 dhe 06.03.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni, të dëmtuarit D.P., nga Mitrovica, të dëmtuarit F.B., dhe përfaqësuesit të dëmtuarit av.Isa Hyseni nga Mitrovica, sipas autorizimit, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij av.Musa Damati nga Mitrovica, sipas autorizimit, dhe av.Mone Sylja nga Gjakova, me autorizim zëvendësues, me datën 11.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.08.04.2024**, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të akuzuarit:**

**A.D.**, nga i ati ..., e ëma ... e vajzërisë ... i lindur me dt.... në Prishtinë, tani me banim në Mitrovicë, Rruga “...” nr. 25, Lagja ..., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ndërtimtari, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**I.Sepse** me datën 01.01.2022, rreth orës 02:05 minuta, në Mitrovicë në rrugën .... afër librarisë “...” së bashku me të miturin E.M. i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarin F.B., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që më parë kishin në mes të dëmtuarit i cili ishte fillimisht në shoqërim me M.Rr., dhe D.P., në një anë dhe në anën tjetër dy të pandehurit ku ishin të përfshirë edhe të miturit E.M. dhe E.H. i pandehuri A.D., dhe i mituri E.M. e godasin disa here me thikë të dëmtuarin F.. pas shpine dhe në abdomen ku i shkaktojnë plagë shpuese të indeve të buta të regjionit të barkut, të regjionit të kafazit të kraharorit, krisje traumatike e veshkës së majtë, grumbullim i gjakut në hapësirën në mes të mushtjellësve të mushkërisë së majtë dhe grumbullim minimal i gjakut në hapësirës në mes të mbështjellësve të mushkërisë së majtë gjak mbledhje në parenkimën e veshkës së majtë, gjak mbledhje për rreth veshkës së majtë, gjak mbledhje nën lëkurore në anën e majtë të murit të barkut dhe në anën e majtë të regjionit i dorë grumbullim nën lëkuror i ajrit në anën e djathtë të murit të barkut dhe anën e djathtë të regjionit

ijor grumbullim i ajrit për rreth mëlçisë, të shkaktuar nga shkaktimi mekanik i mjetit shpues i mprehtë me maje lëndime këto të rënda trupore dhe të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimi.

- **Me çka ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 186 par.3 nën par. 1.3 lidhur me par.1 nën par.1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

**II.Sepse** Në ditën, kohën dhe vendin si në pikën I të dispozitivit në bashkëveprim me të miturin E.H. i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit D.P., ashtu që në të njëjtin e godasin me thikë dhe me grushta ndrydhje të indeve të buta të regjionit plagë prerëse – shpuese të indeve të buta të regjionit të kofshës të këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i kombinuar i mjetit të fortë mbretës dhe mjetit prerës – shpues e që janë dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm për shëndet.

- **Me ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 69, 70, dhe nenit 76, 79, nenit 186 par.3 nën par. 1.3 lidhur me par.1 nën par.1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nenin 185 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shpall dënimet si vijim:

**Të akuzuarit A.D i shqipton veç e veç dënimet për secilën vepër penale dhe atë:**

- **Për veprën penale nën. I** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej **1 (një) vite e 10 (dhjetë) muaj.**
- **Për veprën penale nën II,** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj.**

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

**ME DËNIMIN UNIK ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.01.01.2022 deri me dt.31.03.2022 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.31.03.2022 deri me dt.29.04.2022, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuari: F.B., D.P., dhe .M.Rr., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari A.D., nga Mitrovica, që të paguajë shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100.00 €, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 100.00 €, po ashtu edhe shumë prej pesëdhjetë 50.00 €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.1/22, të datës 29.04.2022, kundër të akuzuarit A.D., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje me të miturin E.H nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- Gjykata ka konstatuar se kjo çështje është pranuar në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjakovë sipas Marrëveshjes së Kryetarëve të gjykatave dhe KGJK-së që kjo çështje të gjykohet në Gjykatën themelore në Gjakovë për shkak të ngarkesës së madhe të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
- Po ashtu këtë çështje do ta përfaqësojë prokurori nga prokuroria Themelore në Prizren meqenëse edhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka bërë transferimin e lëndëve në Prokurorinë Themelore në Prizren.
- I akuzuari dhe mbrojtësi i tij dhe të dëmtuarit nuk kanë vërejtje lidhur me kompetencën e Gjykatës dhe të trupit gjykues.

I akuzuari A.D., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të vrasjes së tentativë sipas pikës I të akuzës, ndërsa e ka pranuar veprën penale të lëndimit të lehtë sipas pikën II të akuzës në shqyrtimin fillestar ku Gjykata ia ka aprovuar pranimin e fajësisë për pikën II të akuzës të përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës e cila fjalën përfundimtare e ka paraqitur në formë të shkruar duke dhënë arsyet se akuza është bazuar

Përfaqësuesi i të dëmtuarit av.Isa Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, duke shtuar se fjalën përfundimtare e kam paraqitur në formë të shkruar (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.03.2024).

I dëmtuari F.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të përfaqësuesit tim dhe të prokurores së shtetit dhe nuk kam çka të shtoj.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.D., av.Mone Sylja, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të cilën e ka paraqitur në formë të shkruar duke dhënë arsyet se akuza është e pa bazuar (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.03.2024).

I akuzuari A.D., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi deklarin e mbrojtëses time dhe tjetër nuk kam se çka të shtojë.

## 2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari A. D., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale te vrasjes ne tentativë sipas pikën I të akuzës, ndërsa ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor sipas pikës II të akuzës, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike sipas pikës I-rë të akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova si: ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit - të dëmtuarit

F.B., D.P., dhe M.Rr., si dhe dëshmitarët E.M., dhe B.SH., R.SH., si dhe ka administruar provat materiale që janë propozuar nga palët dhe atë: Raporti informues hetimor i dt.01.01.2022,

Raporti i oficerit A.U., 01.01.2022, Raporti i oficerit SH.S.,dt.01.01.2022, Raporti i oficerit SH.S., dt.01.01.2022, shënimi zyrtar i E.A., dt.01.01.2022, shënimi zyrtar dt.01.01.2022 E.A., F.R., Raporti mjekësor dt.01.01.2022 në emër të M.RR., Raporti mjekësor dt.01.01.2022 në emër të D.P., informacionet e personin A.D., informacionet e personin F.SH., Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me foto dokumentacioni i dt.01.01.2022, skica dhe lista e dëshmive dt.01.01.2022, fletë lëshimi nr. 5/22 i dt.01.01.2022 dhe raporti mjekësor dt.19.01.2022 raporti mjekësor i dt.25.01.2022 në emër të lista F.I. e dëshmive dt.01.01.2022, (rroba të viktimës F.I.), ekspertiza mjeko ligjore 11.02.2022; fotoalbumi lidhur me identifikimin si dhe CD - video incizimi i vendin e ngjarjes, si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A.D.,

## 2.1. Deklarata e të dëmtuarve të dhënë në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1 I dëmtuari-dëshmitari F.B., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se ditën kritike me datë 01.01.2022, mbas orës 24:00/h, të vitit të ri, në orën 24:30/h jam takuar me M... dhe D., të cilët i kam shokë, dhe kemi dal prej shtëpisë së atyre dhe kemi shkuar në Lagjen Tjegullore, dhe mandej ka dal një djalë dhe ka thënë mos bërtitni, ka qenë një djalë i vogël, mandej ka shkuar ai dhe e ka marrë një stubcë me na qellu neve treve, pastaj ka qenë një djalë në lagje dhe e ka larguar atë, pastaj na kemi ik prej atyhit, dhe mbasi 5-10 minutave i ka shkruar dikush M.. në telefon, dhe i ka thënë se unë jam ai shoki që patet problem me atë djalin, dhe a mundeni me na prit, ku ne kemi pritur tek libraria G., dhe ne i kemi pritu 10 minuta deri sa kanë ardhur ata, saktë nuk e di se sa kanë ardhur, kanë ardhur për afërsisht 10 veta, disa kanë ardhur prej anës së majtë disa prej anës së djathtë, ku prej tyre kur ka ndodhur rasti kam njohur vetëm F... Si kanë ardhur, na kanë sjell direkt, e di që katër veta kanë ardhur tek unë, te M... qashtu. Mua më kanë goditur në barkë në anën e djathtë dhe në shpinë dhe i kam marr 5 goditje, me thikë, nuk kam mujt me e pa thikën sepse ka qenë terr nuk kam pa se çfarë thike ka qenë. Pas këtyre goditjeve, ata janë larguar, unë kam parë gjak, edhe na jemi larguar dhe kemi dal në rrugë kryesore, dhe kemi parë se kemi qenë që të tretë të therur dhe e kemi thirre ambulancën. Mendojë se kanë qenë dy persona, pasi që kur më kanë ther në shpinë ka qenë permas, dhe kur jam rrëzuar në tokë më kanë therr në bark dhe kam shkuar afër D...E.. nuk ia di se kush më ka goditur i pari, por ka qenë në shqyrtimin fillestar F.. nuk ka qenë, por P... ka qenë përpara, dhe 3 veta i kam pasur përmbas. Të akuzuarin nuk e ka njohur më përpara. Po familjarët e të gjithëve kanë qenë për pajtim. M.. i ka shkruar në telefon A. Tregova si më lartë nga ai fëmija në lagje ndodhi ajo përleshje natën kritike. Në telefonin e M.Rr., dhe mesazhi ka qenë shkruar kështu: jam ai djali që ishit në lagje dhe pritnani se po vijim pas 5-10 minutave. Po na ka treguar, dhe ne i kemi thënë nguti se ftohtë. Me M... janë afër me shtëpia dhe i kanë shkruar në Instagram, djali i vogël e ka njohur M... dhe iu ka treguar këtyre. Unë as nuk kam parë thikë. Për afërsisht një minutë tek unë, ku unë jam ther mbas në shpinë, P. më ka dal përpara, veç kur ma ka hi në anën e djathtë më ka dhim të shumë, ndoshta me thikë, aty e kam parë që jam i therur dhe më ka dhim të shumë. F... nuk ka qenë afër meje por ka qenë tek M....

2.1.2 I dëmtuari-dëshmitari M.Rr., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se me datën 01.01.2022, së pari jemi takuar unë, D... dhe F.. ka qenë pas orës 24:00/h, ku jemi takuar në Tjegullore dhe pastaj tek ato banesat ka dal një djalë i mitur, dhe na u drejtua neve dhe na ka thënë se mos bëni zhurmë, ku D.. i ka thënë se nuk jemi duke bërë zhurmë, ndërsa ai tha pritni qitu, se tash ju tregojë, ku i njëjti ka ardhur me një stubcë, dhe nuk kemi pasur përleshje fizike dhe jemi larguar, kur kemi arritur tek Libraria .. më ka shkruar në telefon E.M., më ka thënë, se ku je, se kemi me u zatet unë e ti nesër se nuk jam këtu, unë i kam thënë se jam tek shkolla A.SH., dhe ai më ka thënë, se takohemi nesër, me pretendimin se jemi fjalosur me atë djalin e vogël. Pastaj më ka kontaktuar A.D., nëpërmjet Instagramit dhe më ka thënë se ku je, unë i kam

thënë se jam tek shkolla A.SH., dhe më ka thënë, pritëm qaty, unë i thash okej dhe mbas 3-5 minutave janë ardh 2 persona nga ana e djathë, ndërsa 5-7 persona nga ana e majtë, ku dy personat që ishin veç kanë thënë, se cili është M...dhe kur janë afruar, ma kanë ulur kapuçin dhe më kanë goditur. Nuk e di se kush kanë ata të dytë edhe sot e kësaj dite, pastaj unë jam larguar dhe pastaj e di se jam përleshur me F.. Sh., E.. M... dhe E. H.... F.. larg meje ka qenë dikund rreth 5 metra larg meje, pasi që na kanë ndarë në tri grupe. F.. dhe D.. kanë qenë afër dhe kanë qenë 6 persona që e kanë sulmuar, mua më kanë sulmuar të parin. F.SH., ka pasur thikë pasi që e kam parë kur më ka ra mu, ku më ka goditur në dorë. Ndërsa nuk ka shkuar sepse ka qenë përballë meje. Në pjesën ku kam qenë unë ka pasur ndriçim dhe kamera, ndërsa në pjesën tjetër ka qenë errësirë dhe kjo përleshja ka zgjatur rreth 5 minuta. Mesazhet i kam shikuar në Stacion Policor i kishte fshirë E., ndërsa të mijat shihen, ndërsa të A... tani nuk i kam shikuar por ia kam prezantuar policisë atë herë. A.. e kam parë se ka ardhur aty. Tek unë ka qenë F.. Sh...E... M..., E.. H...ndërsa tek F.. dhe D.. ka qenë A., R.SH., dhe nuk ka mujt me i pa ata të tjerët, pasi që kanë qenë kallaballëk.

2.1.3 I dëmtuari-dëshmitari D.P., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se me datën 01.01.2022, kam dal me M...dhe jemi takuar me F... në ..., dhe duke u leshu te poshtë na ka dal një djalë, na ishim duke biseduar, dhe ai na tha, mos boni zhurmë, pastaj ne i thamë se nuk mundesh me na ndal se është nata e vitit të ri, pastaj ai tha, pritni pak, dhe ka hy në shtëpi dhe e ka marrë një stubcë, duke u afruar ai me stubcë, ka kaluar një kojshi ku emri nuk po më kujtohet, dhe na ka larguar dhe na ka thënë, se çka jeni duke bërë këtu, dhe pastaj na kemi vazhduar për me dal në qytet, dhe i ka shkruar M..., A.. në telefon, ku i ka thënë se ku jeni, dhe ne i kemi treguar se jemi tek G..., dhe na ka thënë pritni 10 minuta aty, dhe na kemi pritur rreth 15-20 minuta dhe kemi parë se prej një rës anë kanë ardhur 7-8 persona, dhe prej anës tjetër 2 persona, dy personat të cilët ishin në krahun tim ma kanë ul kapuçin dhe më kanë sjellur dhe më kanë rrëzuar në tokë, deri sa janë afruar personat tjerë, dhe nuk e di se kush ka qenë pasi që fokusin e kam pasur tek personat që ishin kallaballëk. E di që së pari më kanë goditur mua, ndërsa F... nuk e kam parë se kush e ka goditur. F... ka qenë afër meje, ndërsa M... ka qenë më larg dhe e di se M... e ka pasur F... afër dhe dy persona tjerë, nuk kam mujt me pa se kush më ka therrur mu, e as F...Në fillimi nuk e kam vërejtur se ka qenë, ndërsa duke u larguar nga aty, ku kemi shkuar në mëhallën tjetër, ku ka thënë F..se po më dhembë dhe se kur ja kam qu maicen e kom pa se ka qenë i therur në bark njëherë. Unë kam pasur në këmbë dy herë, me mjetë të mprehtë thikë. Qaty për qaty jo nuk i kam parë thikë askujt. Është përdorur sprej atë natë, me e pa e njoh por emrin nuk ia di, i cili ka qit sprej tek zebrat duke u larguar, turma që ishte duke ardhur ishte larg dhe unë jam sulmuar nga 2 personat që vinin, shton se A... nuk e ka njohur më parë. Sipas meje nuk ka pasur ndonjë arsye me ndodh kjo ngjarje, unë nuk i kam njohur përpos E..t që e kam pasur në shkollë.

## 2.2 Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1 Dëshmitari B.SH., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën 01.01.2022 në orët e hershme të mëngjesit kemi qenë duke ndejt në një ndej në një lokal ..., aty kemi qenë me F.SH., A.D., M.O., dhe P.S., ku djali i dajës A... kishte pasur problem me këtë atë dëmtuarit pasi që nuk po iu di emrat, ku këta e kishin lënë me u taku atë natë, ndërsa unë kam mbetur në lokal me disa shokë tjetër, kam qenë i pirë, A. është nisur me P., F.. dhe M.. pastaj nuk janë kthyer në lokal por jam takuar me vëllain F.. në shtëpi dhe ma ka treguar ngjarjen, duke më treguar se si janë rrahur me disa, F.. më ka treguar se e ka therur në dorë dikend më duket F. më ka thënë, apo M...ndërsa për A..nuk më ka treguar asgjë.

2.2.2 Dëshmitari E.M., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën 01.01.2022 deri në orën 24:00/h, kam qenë në shtëpi duke festuar për vitin e ri, mandej më ka ardhur një mesazhe prej A.G., të cilin e kam shok, më ka thënë, se a e njeh M.RR., se pak më herët deshti me më ther në lagje, edhe i kam thënë se po e njoh prej shkollës së mesme, edhe e kam thirr M.... dhe i kam thënë, se çka është puna, pasi që i njifsha të dy palët dhe nuk kam dashur me përfunduar ashtu, por kam dashur me i pajtuar, dhe më ka thënë se jam tek shkolla A.SH., hajde dhe folim këtu, të njëjtën kohë mbasi që A... i ka treguar A..., pasi që janë shok dhe A.i më tha, se kush është M., edhe ia kam dërguar Instagramin e M.. edhe A... më ka shkruar prapë, dhe më ka thënë se mos shko me u taku se nuk po më lenë babi me dal prej shpisë, se e ka marrë vesh, dhe leje nesër dalim e takohemi me ta, dhe unë e lash, edhe dola tek rrethi me lyp taksi për me shkuar në qytet, dhe rastësisht pas 10-15 minutave u takova aty me A.. tek rrethi tek lagjja e .....pak më andej, dhe më tha se e kam lënë me u taku me M...për me u sqaruar mos me i lënë me bo problem. A... e njoh moti, e kam pas shok të lagjes, dhe prej se ka ndodhur ngjarja, babi nuk më lejon me ndejt me te. Me A... kanë qenë disa njërin prej tyre e kam njohur ka qenë F.SH., E pyeta se ku e ke lënë me u taku me ta, më tha tek G...dhe unë kam shkuar me ta dhe pa pritë si jemi afruar, M... më ka sulmuar dhe jam vetëmbrojtur, ku njëherë rash në tokë, ku tentojë me më godit me grusht dhe u vetëmbrojta. F.. nuk e di, nuk e kam parë, pasi që kur jam goditur herën e parë mu ka marrë mendtë, e nuk e kam parë. F..i kam parë thikë në dorë, e kam parë që e ka therë në dorë M.... Duke u larguar ka bërtitur M... dhe e kishte dorën gjak, e ka nxjerrë një thikë dhe unë kam ikur, pjesa tjetër ka mbetur prapa, dhe unë direkt kam shkuar në banesë. Prokurorja e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici në faqen e dytë keni deklaruar, në pyetjen e zyrtarit policor “Më herët keni deklaruar se A.i të ka thënë se njërin e kam ther nja 2-3 herë, në cilin moment ti ka thënë A... këto fjalë, dhe për kënd e ka pasur fjalën se e ka ther 2-3 herë, “ndërsa ju jeni përgjigjur se këto fjalë mi ka thënë tek kur ka përfunduar rasti, e për kënd ka thënë nuk e di”, a është e vërtetë kjo çka keni deklaruar në polici në prezencën e prindit tuaj? Dëshmitari po është e vërtetë, meqë këtë e kam deklaruar, mbesë pranë këtij deklarami.

2.2.2 Dëshmitari R.SH., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën 01.01.2022 pas orës 24:00/h jemi nis me E.H., me shkuar me luajt Sony, rrugës duke shkuar tek ....i kemi parë disa persona, ku ka qenë A.i shoku im i mëhallës dhe pala tjetër, F., M.. dhe D., kur kemi qenë duke u afruar i kemi parë duke u shtyrë, dhe në atë moment e kam parë se ka qenë shoku im i mëhallës A..dhe na jemi nis me qëllim me i zbut gjakrat, me i nda, në atë moment ka filluar kacafytja, ku F.. e kom pa me M.. edhe ka qenë tollovi e madhe e di se shoku im E. ka bërtitur, o dora, unë kam qenë afër tij, dhe kur e kam kthyer kryet kam parë që i ka nis me i rrjedh gjak, në atë moment qaty për qaty unë kam humbur, kur më ka nxën gjaku, ku në atë moment e kam pasur një sprej në gjep, e kam nxjerr sprejin për me u vetëmbrojtje, pasi që kur kam hi në mes, nuk më kujtohet se në mes të kujt e të kujt, dhe në momentin kur e kam nxjerr sprejin, M.. ka qenë duke mu vërsul mua, dhe e kam nxjerr sprejin me u vetëmbrojtje. A. nuk kam mujt me e vërejt, kam vërejt F.. nuk e di a ka qenë duke u përlesh me M... a D...por e kam vërejt se ka pasur një thikë në dorë. A. se e kam pas shok të fëmijërisë, ndërsa F.in e kam njohur se kam punuar tek shtëpia e tij. Ka pasur ndriçim rrugor, por jo edhe aq. Përveç F. nuk i kam parë askujt thikë. Ka qenë diku maksimumi 1 metër, ndërsa unë kam qenë tek xhama e dyqaneve. A... më ka treguar se kam qenë shumë i pirë dhe nuk mban mend shumë sende. F.. e ka filluar kacafytjen dhe e ka gjuajtur me grusht M...ose D.. kanë qenë të gjithë të përfshirë në këtë kacafytje. Në atë tollovi saktë nuk mund të them se e ka sulmuar dikend A.. por ka qenë duke u kacafytur. A... e kam parë tek dyqani, e kur është plagosur E..e kom pa se A..e kom pas përmbas.

### 2.3. Provat materiale

2.3.1. Nga Raporti informues hetimor i Sektorit Rajonal të Hetimeve në Mitrovicë i datës 01.01.2022, janë konstatuar veprimet e ndërmarra nga zyrtarët policor në vendin e ngjarjes në rr. “..” pranë rrethit të vogël dhe librarisë “.....” në Mitrovicë, ku rreth orës 03:30/h kishte ndodhur një rast ku ishin sulmuar fizikisht dhe ishin therur me thikë tre viktime ndër ta F. Bajrami, ishte i lënduar më rëndë dhe ishte dërguar për në QKUK- Prishtinë për trajtim të mëtutjeshëm për shkak të gjendjes së rëndë, ndërsa të dëmtuarit M.RR., dhe D.P., ishin të lënduar respektivisht të therur me thikë në gjendje më të lehtë ku pas trajtimit mjekësor ishin lëshuar dhe ishin dërguar në Stacionin policor në Mitrovicë për tu intervistuar, ndërsa të dyshuar ishin E... M..., F.SH., dhe i dyshuari A.D., për veprën penale vrasje në tentativë dhe bashkëkryerje, po ashtu i dyshuar E.H., për veprën penale pjesëmarrje në rrahje. Ku viktimat pas prezantimit të fotoalbumit prej 10 fotografive kishte identifikuar të dyshuarit A.D., dhe F.SH.,

2.3.2. Nga Raporti i oficerit A. U. i datës 01.01.2022 i përpiluar në orën 04:40/h, është konstatuar se me datë 01.01.2021 veprimet e ndërmarra nga ana e zyrtarëve policor të Stacionit Policor Jug në intervalin kohor prej orës 02:04/h e deri në orën 03:40 /h, ku si pasojë e përlëshjes në mes personave në rr. “....” pranë rrethit të vogël dhe librarisë “...” në Mitrovicë, është bërë sigurimi i vendit të ngjarjes ku janë gjetur njolla gjaku, e hetuesit kanë bërë fotografit e vendit të ngjarjes, dhe janë marr me rastin, e ku të lënduar ishin M.RR., F.I., D.P., ndërsa të dyshuar janë E.M., A.D., ku nga ana e hetuesve është bërë bastisja e shtëpisë së A.D., tek .... e që i njëjti nuk është gjetur aty e që rasti është iniciuar si vrasje në tentativë.

2.3.3. Nga Raporti i oficerit SH.S., me numër të rastit 2022-BC-0002 i datës 01.01.2022, është konstatuar se me datë 01.01.2022 gjatë patrullimit të njësitit BC 302 tek Rr. “...”, rreth orës 02:04/h, është kërkuar patrullë shtesë nga njësit BC 303, meqë zyrtarët policor kishin në hasur në një autoambulancë e cila po bënte transportin e tre personave të lënduar nga një rrahje, ku njëri njësit kishte përcjellë autoambulancën ndërsa njësit tjetër kishte mbetur në rrugën “... ..” në kërkim të vendit të ngjarjes. Pasi janë dërguar personat në SR në Mitrovicë, nga mjeku kujdestar pacienti F.I., ishte konstatuar së është therur me mjetë të ftoftë (thikë) në anën e djathtë të stomakut si dhe në shpinë ku i njëjti ishte përcjellë në QKUK Prishtinë për trajtim të mëtutjeshëm për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, ndërsa M.RR., ishte i therur në dorën e djathtë të shuplaka e dorës dhe kishte lëndime në kokë në anën e djathtë afër veshit, ndërsa D.P., i njëjti kishte marr një lëndim në anën e djathtë afër syrit si dhe ishte i therur me thikë në këmbën e majtë mbi gju, ku nga të dëmtuarit D.P., dhe M.RR., kanë mësuar se ngjarja ka ndodhur rr.“...” pranë rrethit të vogël dhe librarisë “... në Mitrovicë si dhe personat e dyshuar ishin E.M., A.D., ku dhe kanë lajmëruar njësitin BC303 për vendin e ngjarjes dhe janë njoftuar se janë sulmuar nga dhjetë a më tepër persona.

2.3.4. Nga Raporti informues i zyrtarit policor F.G., tek zyrtari F.Z., dhe B.D., është konstatuar se me datën 01.01.2022 rreth orës 02:15/h nga baza zyrtarët policor janë njoftuar se tre persona gjenden në Emergjencë në Spitalin Rajonal në Mitrovicë që dyshohet se janë të therur me mjet të mbrehtë (thikë) ku njëri nga ta ishte në gjendje kritike, ku pas kontaktimit me mjeken kujdestare Dr. S.S., të Spitalit Rajonal në Mitrovicë ishin njoftuar se viktime F.B., është dërguar urgjent për QKUK-Prishtinë pasi që ka qenë në gjendje kritike dhe i therur në bark, mëlçi dhe veshkë, i moshës rreth 18 vjeçar, po ashtu M.RR., i lindur me 2003 i lënduar në dorë dhe kokë me mjetë të fortë të mbrehtë, dhe D.P., i lindur 2003 i lënduar në këmbë dhe pasi që iu është dhënë ndihma nga mjeku janë liruar dhe janë dërguar në stacion për intervistim. Menjëherë janë lajmëruar hetimet rajonale dhe kanë shkuar ndërsa në vendin e ngjarjes ka pasur vetëm njolla gjaku, rasti kishte ndodhur në Rr. “...” tek rrethi i vogël, ku i dyshuari E.M., ishte arrestuar, ndërsa i dyshuari A.D., ishte kërkuar në shtëpi por nuk ishte gjetur dhe rreth orës 05:10/h i njëjti

ishte dorëzuar në polici, kurse i dyshuari F.SH., ishte arrestuar nga patrulla në qytet dhe ishte sjell në Stacion Policor.

2.3.5. Nga Shënimi zyrtar i rreshter E.A., i datës 01.01.2022, është konstatuar se janë intervistuar të dyshuarit F.SH., A.D., E.H., dhe E.M., po ashtu janë intervistuar edhe viktimat M.RR., dhe D.P., ku viktimës iu është prezantuar fotoalbumi me 10 fotografi, dhe pas marrjes së deklaratave dhe analizimit të provave nga prokurori për të mitur Znj. Z.K., të dyshuarit E.h., iu është ndërpre masën e ndalimit prej 48 orëve dhe prokurorja e ka ri kualifikuar veprën penale ndaj të dyshuarit E.M., nga vrasje në tentativë në veprën penale pjesëmarrje në rrahje.

2.3.6. Nga Shënimi zyrtar i rreshter E.A., dhe zyrtarit policor F.R., i datës 01.01.2022, është konstatuar se viktimës F.B., i cili gjendej trajtim në QKUK -Emergjencë me lejen e prokurorit të shtetit z. N.B., i është prezantuar albumi me dhjetë fotografi, ku i njëjti ka identifikuar foton me numër 9 dhe nr.1, si persona që e kanë sulmuar dhe e kanë goditur me thikë, e që në foto nr.9 është identifikuar i dyshuari F.SH., ndërsa në foton numër 1 i dyshuari A.D., . - Dr. S.B , i ka njoftuar se viktimë ka katër (4) plagë shpuese nga mjeti i mprehtë dhe një lëndim në syrin e majtë, tri (3) plagë shpuese nga mjeti i prehtë i ka në shpinë në pjesën e poshtme dhe një plagë shpuese në abdomen.

2.3.7. Nga Raporti mjekësor për pacientin M.RR., , i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencë në Mitrovicë, me numër të protokollit 12, të datës 01.01.2022, është konstatuar se i njëjti është pranuar në këtë spital për trajtim mjekësor, ku i janë bërë ekzaminimet e nevojshme mjekësore, dhe i është dhënë ndihma e parë nga Dr. F.K.,

2.3.8. Nga Raporti mjekësor i datës 01.01.2022 në emër të D.P., i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencë në Mitrovicë, me numër të protokollit 10, të datës 01.01.2022, është konstatuar se i njëjti se i njëjti është pranuar në këtë spital për ekzaminim mjekësor dhe është trajtuar nga mjeku kujdestar.

2.3.9. Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me foto dokumentacioni i datës 01.01.2022, skica, lista e dëshmimeve dt.01.01.2022 i përpiluar nga Njësia e Forenzikës në Mitrovicë me nr. rastit 2022-BC-002 së bashku me fotoalbumin prej 32 fotove me ngjyra, skica e vendit të ngjarjes me tabelën e matjeve në vendin e ngjarjes, të datës 01.01.2022, ku shihet vendi i ngjarjes në rrugën "...", afër librarisë ".." tek rrethi, dëshmitë D1,D2,D3, D4 ku shihen njolla dyshohen në njolla të gjakut, të përshkruara distanca në mes njollave në tabelën e matjeve, rrobat e viktimës F.I., të evidentuara me numra rendor, po ashtu rroba tjera me njolla gjaku me dëmtime në to të shkaktuara nga mjeti i mprehtë (thika) fotografit nr.11-16, po ashtu të mbathura si patika, rrobat si jakne, framerka, një telefon fotografit nga 17 deri në 22, lëndimet e shkaktuara nga mjeti i mprehtë në dorën e djathtë dhe në anën e djathtë të kokës M.RR., fotografit 23-26, fotografit e D.P., si dhe lëndimet në këmbën e majtë po ashtu fotografit e fytyrës ku shihen lëndimet në mollëzën e djathtë fotografit nga 27 deri në 32.

2.3.10. Nga fletë lëshimi me nr.amzë:5/22 të datës 01.01.2022 dhe raporti mjekësor dt.19.01.2022 raporti mjekësor i dt.25.01.2022 në emër të F.I., e dëshmimeve dt.01.01.2022, (rroba të viktimës F.I., ), është konstatuar se i dëmtuari F.I., ka qëndruar i hospitalizuar në SHSKUK-Klinika e Urologjisë në Repartin B nga data 01.01.2022 e deri me datë 14.01.2022, ku është mjekuar nga mjekët profesionalist urologu pasi që i njëjti është pranuar si rast urgjentë dhe ka pas nevojë për trajtim urgjentë, po ashtu nga raporti mjekësor datë 19.01.2022 është konsultuar nga Dr. S.M., -Urolog.



2.3.11. Nga Akt Ekspertimit i përpiluar nga eksperti i mjekësisë ligjore Dr. V.K., i datës 11.02.2022, lidhur me ekzaminimin e të dëmtuarit F.B., ka konstatuar se i njëjti ka marrë plagë prerëse-shpuese të indeve të buta të regjionit të barkut, të regjionit të kafazit të kraharorit, krisje (çarje, plasaritje) traumatike e veshkës së majtë, grumbullim i gjakut në hapësirën në mes të mbështjellësve të mushkërisë së majtë dhe grumbullimi minimal i gjakut në hapësirë në mes të mbështjellësve të mushkërisë së djathtë, gjak mbledhje në parenkimën e veshkës së majtë, gjak mbledhje për rreth veshkës së majtë, gjak mbledhje nën lëkurore në anën e djathtë të murit të barkut dhe në anën e djathtë të regjionit iJOR (lumbal), grumbullim nën lëkuror i ajrit në anën e djathtë të murit të barkut dhe anën e djathtë të regjionit iJOR, grumbullim i ajrit për rreth mëlçisë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit shpues ( i mprehtë, me maje) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore dhe të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit. Po ashtu lëndimet e shkaktuara tek i dëmtuari M.RR., , ku janë konstatuar ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të kokës dhe plagë çarëse-shqyerës të indeve të buta të regjionit të shuplakës së dorës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë, i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, po ashtu lidhur me ekzaminimin e të dëmtuarit D.P., ka konstatuar se tek i njëjti ka ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të fytyrës dhe plagë prerëse-shpuese të indeve të buta të regjionit të kofshës së këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i kombinuar i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë, i topitur) dhe mjetit prerës-shpues ( i mprehtë, me teh dhe maje) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

2.3.12.Nga fotoalbumi lidhur me identifikimin është konstatuar se në letër format A4 gjenden 10 foto me ngjyra ku në foton nr.1 është identifikuar i pandehuri A.D., dhe në foton nr.9 identifikuar i pandehuri F.SH.,

2.3.13.Nga shikimi i CD-së së vendit të ngjarjes, gjykata ka vërtetuar se si ka ndodhur rasti natën kritike, ku janë përleshur tek libraria... ku në atë lokacion janë përleshur të ndarë në dy grupe ku në grupin tel Librari shihet i dëmtuari F. dhe i akuzuari A.D., , po ashtu shihen dy grupe të rinjve duke u përleshur si dhe një person vërehet ka bërë edhe incizimin me telefon.

## 2.4 Mbrojtja e të akuzuarit

2.4.1 I akuzuari A.D., , gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të vrasjes në tentative sipas pikës I-rë të akuzës, ndërsa në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësisë për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor sipas pikës II të akuzës ku Gjykata ia ka pranuar pranimin e fajësisë, ndërsa në mbrojtjen e tij rreth veprës penale të vrasjes në tentativë ka deklaruar se unë nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohem sipas pikës I të akuzës duke deklaruar se natën kritike kemi dal pas orës 24:00/h me shoqëri tek një lokal me emrin ..., ku aty u kon E.M., ku jemi taku, ku ka filluar me shkruar me dike në telefon, dhe më tha se u kapa me qita, a mundesh me i shkruar edhe ti se nuk kam shumë bateri, mandej uni i shënova, tha me vet se ku je, kam biseduar me M... dhe më tha se jam te libraria G...dhe E.. më tha, thuaj se për 10 minuta aty jemi, dhe jemi nis me shkruar menjëherë me F.SH., , E.H., M.O., dhe R.SH., , dhe kur shkua aty ka qenë M... me dy të tjerë, të cilët nuk i kam njohur, dhe fillojë me biseduar E.. me M..., ku duke biseduar fillojë me u tensionu situata dhe ja nisën me u rreh me grushta, dhe mandej ja kemi filluar që të gjithë, ku dy persona kanë pasur thika, po nuk e di saktë se kush kanë qenë, se kam qenë në ndikim të alkoolit dhe njëri ka qenë duke ardhur në drejtim timin dhe më ka shtyrë dikush prej anash dhe jam rrëzuar në tokë, dhe e kam pas një thikë në xhep, dhe duke u mundu me u qar e kam qelë diqysh dhe me dije unë kërkend nuk e kam goditur dhe janë ndi alarmat e policisë dhe mandej jemi ik të gjithë. Nuk kam pasur ndonjë

qëllim por i shkruva për me i kryer një shërbim pasi që nuk kishte bateri. Unë personalisht kam dal për me festuar, dhe unë nuk e kam njohur asnjërin. Unë thjeshtë kam shkuar për me i nda, nuk kam shkruar për ndonjë qëllim. Me grushta kam gjuajt, por nuk e di kujt. Pasi që ata erdhën në drejtim timin e unë pastaj i sulmova. Kam qenë shumë i dehur pasi që kam pirë në shtëpi, mandej edhe kur kam dal i kam pirë 5-6 birra, nuk kom pas për qëllim me privua dikend nga jeta, e as ta lëndojë dikend, thjeshtë jam munduar me u mbrojtë. Thikën nuk e kam përdorë, pasi që si jam qu në këmbë i kam ndi alarmat e policisë dhe kemi fillua me ik. Unë ndiejë shumë keqardhje, nuk kam shkuar për ndonjë qëllim të keq, kam shkuar për me ndihmuar mos me u bo më keq. Me palët e dëmtuara nuk kam ndonjë problem. E.M., e kam shok të mëhallës. Dhe atë natë jemi takuar në lokalin ... dhe me tha me i shkruar M..., kam mujt me ja jap telefonin E. por nuk ma ka lyp, më ka thënë se a mundesh me i shkruar, dhe i kam shkruar, në lokal kur kam shkuar kam pirë diku nja 5-6 birra, testin e alkoolit policia nuk ma ka bërë, edhe pse iu kam treguar se kam pirë. Nuk e kam dorëzuar thikën, ndoshta më ka ra rrugës duke ik, ku pas ngjarjes kam ndejtë në mëhale dhe pastaj kam shkuar jam dorëzuar në polici. Nuk ka qenë e imja, thikën ma ka jap në rrugë E.M., , nuk më kujtohet saktë se çfarë ka qenë, nuk ka qenë edhe e madhe, nuk e di që ka qenë e madhe, ne kemi shkuar veç për me fol, e pastaj u tensionua situata dhe pastaj ka filluar përleshja. Kanë shkuar disa pleqnarë për mu pajtuar, nuk e di pasi që kam qenë në paraburgim, të familjes së F... Në këtë përleshje kanë marr pjesë rreth 5-6-7, nuk e di saktë. Unë thjeshtë e kam marrë thikën, kam qenë në ndikim të alkoolit, nuk është që e kam menduar atë send. Gjykata e ka ballafaquar me deklarin e E...ku i njëjti ka thënë se nuk ia kam dhënë thikën A..? I akuzuari ka deklaruar se ndoshta nuk ka thënë të vërtetën. Gjykata e ka ballafaquar se E.. ka deklaruar se ju i keni thënë se e keni goditur dikend dy herë, a është e vërtete kjo? I akuzuari ka deklarua se nuk është e vërtetë, pasi që unë nuk kam biseduar me te, dhe nuk jam takuar me te deri sa nuk jam liruar nga paraburgimi. Kam qenë në ndikim të alkoolit, dhe kur pi disa sende më kujtohen e disa jo. Gjykata ka pyet se pse ju keni pranuar që keni goditur me thikë D.P., , ndërsa tani po thuani se nuk e kam përdorur thikën? I akuzuari ka deklaruar se nuk kam ditur se po bëhet fjalë për therje, kam menduar se po bëhet fjalë veç për përleshje, kam pas sipas detyrës zyrtare mbrojtës. Dhe e kom njoftuar, ndërsa mua nuk më ka shkuar mendja se duhet me kërkuar me e bo testin. Gjykata ka pyet se në shqyrtimin fillestar e keni pranuar fajësinë për veprë penale lëndim i lehtë trupor, a keni pasur mbrojtës në atë seancë? I akuzuari ka deklaruar se po kam pasur mbrojtës dhe jam konsultuar me te. E....me tha se po shkojmë me fol për qata se për çka ishin kap, për çka janë kap e kam kuptuar pas daljes nga paraburgimit se këta kanë qenë në mëhallën time për me ble drogë, dhe një i mitur A.G., ka dal dhe i ka thënë, se mos bërtitni, dhe këta e kanë nxjerrë një thikë, dhe këta një stubcë dhe i ka nda dikush i mëhallës. Nuk kuptova asgjë pasi që kam qenë në ndikim të alkoolit, dhe veç e mora thikën, shton se nuk pasur qëllim që ta privojë nga jeta askënd, pasi që palën e dëmtuar nuk e kam njohur e as që kam pasur ndonjë konflikt më herët, kërkujë falje për këtë që ka ndodhur, dhe tjetër nuk kam se çka të shtoj.

### 3. Elementet e veprave penale

Në nenin 172 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vrasjes e kryen: “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim”. Ndërsa në nenin 28 është paraparë “Tentativa” ku në parg.1 të këtij neni është paraparë “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. Ndërsa parg.2 i po këtij neni parasheh se “Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose me shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë vepër penale tjetër, dënohet vetëm nëse shprehimisht e parashihet me ligj” ndërsa në

parag.3 të po këtij neni parashihet se “Personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet”.

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi të lehtë trupor e kryen: “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor”, ndërsa nën paragrafi 1.4 ka përcaktuar se “kur kemi dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”. Ndërsa paragrafi 2 ka përcaktuar se: “kur vepra penale nga paragrafi 1 kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.”

Në nenin 186 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi i rëndë trupor e kryen: par.1 “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të rëndë trupor”, personit tjetër ose dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me 1.1 dobësimin e përkohshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit të personit tjetër. Ndërsa par.3 parashihet “Kur vepra penale nga par.1 dhe 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit”, kryesi dënohet me; 3.1 burgim prej 1 (një) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga par.1 i këtij neni.

#### 4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Lidhur me piken e parë të dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se pjesërisht duhet t'i falet besimi deklaratimit të akuzuarit A.D., , të dhënë gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore me të cilën e ka mohuar kryerjen e veprës penale te vrasjes ne tentativë, pasi që kjo Gjykatë fillimisht është lidhur me motivin e kryerjes së veprës penale pasi që konflikti ka lindur natën e vitit të ri, ku si pasojë e një të mituri ka lindur konflikti ku këtë e tregojnë edhe vet të dëmtuarit pasi që të njëjtit tregojnë se kemi shkuar tek një lagje dhe na ka dal një i mitur duke na thënë se mos bëritni dhe i kanë thënë se nuk jemi duke bëritur dhe i njëjti ka thënë pritini dhe ju ka dal me një stubcë dhe pastaj një kalimtar i ka ndarë dhe janë larguar, pastaj ka rrjedh ngjarja tjetër ku i akuzuari ka qenë në lokal në një lokal me emrin Bumerang, ku aty u ka qenë edhe E.M., i cili ka qenë duke u shkruar me dike në telefon, dhe i ka thënë se u kapa me qita, dhe i ka thënë a mundesh me i shkruar edhe ti se nuk kam shumë bateri, mandej i ka shkruar M.. dhe i ka thënë se jam te libraria G... dhe E.. i ka thënë, thuaj se për 10 minuta aty jemi, dhe jemi nis me shkuar menjëherë me F.SH., , E.H., M.O., dhe R.SH., këtë e pohojnë edhe dëshmitarët dhe të dënuarit se deri te takimi mes tyre kështu ka ndodhur, pra shikuar në këtë pikëpamje gjykata ka vërtetuar se i akuzuari me të dëmtuarin nuk kanë pasur ndonjë motiv po ashtu nuk janë njohur ne mes vete me përpara nuk kanë pasur ndonjë mos marrëveshje mes tyre, por ngjarja ka ndodhur natën kritike ku sipas këndvështrimit të gjykatës se dy grupe të rinjëve pa asnjë arsye janë përfshirë në konflikt – përleshje e cila ka rezultuar me lëndimin e tre të dëmtuarve F.B., D.P., dhe M.Rr., pra qëllimi i të akuzuarin nuk ka qenë privimi nga jeta e të dëmtuarit F.B., , pra kjo Gjykate vërteton se i akuzuari nuk ka pasur dashje që të njëjtin ta privoj nga jeta, pasi që natën kritike ka ndodhur një përleshje e ndarë në dy grupe ku janë të përfshirë mbi 8 persona.

Gjykata nga dëshmia e të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit F.B., , ka vërtetuar se natën kritike pas incidentit me atë djalin e vogël në lagje, mbas 5-10 minutave i ka shkruar dikush M... në telefon, dhe i ka thënë se unë jam ai shoku që patet problem me atë djalin, dhe a mundeni me na prit, ku ne kemi pritur tek libraria ... dhe ne i kemi pritu 10 minuta deri sa kanë ardhur ata,

saktë nuk e di se sa kanë ardhur, kanë ardhur përafërsisht 10 veta, disa kanë ardhur prej anës së majtë disa prej anës së djathtë, ku prej tyre kur ka ndodhur rasti kam njohur vetëm F..si kanë ardhur, na kanë sjell direkt, e di që katër veta kanë ardhur tek unë, te M.. qashtu. Mua më kanë goditur në barkë në anën e djathtë dhe në shpinë dhe i kam marr 5 goditje, me thikë, nuk kam mujt me e pa thikën sepse ka qenë terr nuk kam pa se çfarë thike ka qenë. Mendojë se kanë qenë dy persona, pasi që kur më kanë ther në shpinë ka qenë permas, dhe kur jam rrëzuar në tokë më kanë ther në bark dhe kam shkuar afër D..

Gjykata nga dëshmia e të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit M.RR., ka vërtetuar se natën kritike pas incidentit me atë djalin e mitur në lagje, pastaj më ka kontaktuar A.D., nëpërmjet Instagramit dhe më ka thënë se ku je, unë i kam thënë se jam tek shkolla A.SH., , dhe më ka thënë, pritëm qaty, unë i thash okej dhe mbas 3-5 minutave kanë ardh 2 persona nga ana e djathtë, ndërsa 5-7 persona nga ana e majtë, ku dy personat që ishin veç kanë thënë, se cili është M..., dhe kur janë afruar, ma kanë ulur kapuçin dhe më kanë goditur. Nuk e di se kush kanë ata të dytë edhe sot e kësaj dite, pastaj unë jam larguar dhe pastaj e di se jam përleshur me F.SH., , E.M., dhe E.H., , F... larg meje ka qenë dikund rreth 5 metra larg meje, F... dhe D.. kanë qenë afër dhe kanë qenë 6 persona që i kanë sulmuar, mua më kanë sulmuar të parin. F.. Sh.. ka pasur thikë pasi që e kam parë kur më ka ra mu, ku më ka goditur në dorë, ndërsa nuk ka shkuar sepse ka qenë përballë meje. Tek unë ka qenë F.SH., , E.M., , E.H., , ndërsa tek F... dhe D. ka qenë A.., R.SH., dhe nuk ka mujt me i pa ata të tjerët, pasi që kanë qenë kallaballëk.

Gjykata nga dëshmia e të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit D.P., , ka vërtetuar se natën kritike pas incidentit me atë djalin e mitur në lagje, i ka shkruar M, A., në telefon, ku i ka thënë se ku jeni, dhe ne i kemi treguar se jemi tek ... dhe kemi parë se prej njëres anë kanë ardhur 7-8 persona, dhe prej anës tjetër 2 persona, dy personat të cilët ishin në krahun tim ma kanë ul kapuçin dhe më kanë sjell dhe më kanë rrëzuar në tokë, deri sa janë afruar personat tjerë, dhe nuk e di se kush ka qenë pasi që fokusin e kam pasur tek personat që ishin kallaballëk. E di që së pari më kanë goditur mua, ndërsa F.in nuk e kam parë se kush e ka goditur. F.ka qenë afër meje, ndërsa M.. i ka qenë më larg dhe e di se M.. e ka pasur F.. afër dhe dy persona tjerë, nuk kam mujt me pa se kush më ka therur mu, e as F.., ka theksuar se unë nuk i kam njohur përpos E.. që e kam pasur në shkollë.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.SH., është vërtetuar se i njëjti ka qenë në lokalin Bumerang, aty kemi qenë me F.SH., , A.D., , M.O., dhe P.S., ku djali i dajës A.. kishte pasur problem me këtë atë dëmtuarit, ku këta e kishin lënë me u taku atë natë, ndërsa unë kam mbetur në lokal me disa shokë tjetër, A.. është nisur me P., F.. dhe M... pastaj nuk janë kthyer në lokal por jam takuar me vëllain F.. në shtëpi dhe ma ka treguar ngjarjen, duke më treguar se si janë rrahur me disa, F.. më ka treguar se e ka therur në dorë dikend më duket F.. apo M., ndërsa për A.. nuk më ka treguar asgjë.

Nga dëshmia e dëshmitarit E.M., është vërtetuar se e ka thirr M.. dhe i ka thënë, se çka është puna, pasi që i njëfsha të dy palët kam dashur me i pajtuar, dhe më ka thënë se jam tek shkolla A.SH., , hajde dhe folim këtu, të njëjtën kohë mbasi që A.. i ka treguar A.., pasi që janë shok dhe A.. më tha, se kush është M.. edhe ia kam dërguar Instagramin e M.. t dhe rastësisht pas 10-15 minutave u takova aty me A. tek rrethi tek lagjja e .. dhe më tha se e kam lënë me u taku me M.. për me u sqaruar mos me i lënë me bo problem. A. e njoh moti, e kam pas shok të lagjes, me A.. kanë qenë disa njërin prej tyre e kam njohur ka qenë F.SH., dhe më tha tek G. .i, dhe unë kam shkuar me ta dhe pa pritë si jemi afruar, M... më ka sulmuar dhe jam vetëmbrojtur, ku njëherë rash në tokë, ku tentojë me më godit me grusht dhe u vetëmbrojtta. F.in nuk e di, nuk e kam parë, pasi që kur jam goditur herën e parë mu ka marrë mendtë, e nuk e kam parë. F.. i kam parë thikë

në dorë, e kam parë që e ka therë në dorë M...Duke u larguar ka bërëtitur M.. dhe e kishte dorën gjak, e ka nxjerrë një thikë dhe unë kam ikur, pjesa tjetër ka mbetur prapa, dhe unë direkt kam shkuar në banesë. Po ashtu i njëjti kishte deklaruar se është e vërtetë deklarata e dhënë në polici se A.. i kishte thënë kur ka përfunduar rasti se njërin e ka ther nja 2-3 herë, e për kënd ka thënë nuk e di.

Nga dëshmia e dëshmitarit R.SH., është vërtetuar se duke shkuar tek ... i kemi parë disa persona, ku ka qenë A.. shoku im i mëhallës dhe pala tjetër, F..i, M.. dhe D.., kur kemi qenë duke u afruar i kemi parë duke u shtyrë dhe na jemi nis me qëllim me i zbut gjakrat, me i nda, në atë moment ka filluar kacafytja, ku F..e kom pa me M...., edhe ka qenë tollovi e madhe e di se shoku im E.. ka bërëtitur, o dora, unë kam qenë afër tij, dhe kur e kam kthyer kryet kam parë që i ka nis me i rrjedh gjak, në atë moment qaty për qaty unë kam humbur, kur më ka nxën gjaku, ku në atë moment e kam pasur një sprej në gjep, e kam nxjerr sprejin për me u vetëmbrojtë, pasi që kur kam hi në mes, nuk më kujtohet se në mes të kujt e të kujt, dhe në momentin kur e kam nxjerr sprejin, M... ka qenë duke mu vërsul mua, dhe e kam nxjerr sprejin me u vetëmbrojtë. A.. nuk kam mujt me e vërejt, kam vërejt F. nuk e di a ka qenë duke u përlesh me M... a D.por e kam vërejtë se ka pasur një thikë në dorë. F.. e ka filluar kacafytjen dhe e ka gjuajtur me grusht M... ose D..kanë qenë të gjithë të përfshirë në këtë kacafytje. Në atë tollovi saktë nuk mund të them se e ka sulmuar dikend A.., por ka qenë duke u kacafytur. A.. e kam parë tek dyqani, e kur është plagosur E.. , e kom pa se A. e kom pas përmbas.

Nga provat materiale - fotoalbumi lidhur me identifikimin është konstatuar në 10 fotot me ngjyra, ku në foton numër një është identifikuar i pandehuri A.D., dhe në foton numër nëntë është identifikuar i pandehuri F.SH.,

Nga prova materiale CD-së së vendit të ngjarjes, gjykata ka vërtetuar se si ka ndodhur rasti natën kritike, ku janë përleshur tek libraria ... ku në atë lokacion janë përleshur të ndarë ne dy grupe ku në grupin tek Librari shihet i dëmtuari F. dhe i akuzuari A. D., po ashtu janë të përfshirë dy grupe të rinjve duke u përleshur.

2.3.11. Nga Akt Ekspertimit i përpiluar nga ekspertja e mjekësisë ligjore Dr. V.K., i datës 11.02.2022, lidhur me ekzaminimin e të dëmtuarit F.B., ka konstatuar se i njëjti ka marrë plagë prerëse-shpuese të indeve të buta të regjionit të barkut, të regjionit të kafazit të kraharorit, krisje (çarje, plasaritje) traumatike e veshkës së majtë, grumbullim i gjakut në hapësirën në mes të mbështjellësve të mushkërisë së majtë dhe grumbullimi minimal i gjakut në hapësirë në mes të mbështjellësve të mushkërisë së djathtë, gjak mbledhje në parenkimën e veshkës së majtë, gjak mbledhje për rreth veshkës së majtë, gjak mbledhje nën lëkurore në anën e djathtë të murit të barkut dhe në anën e djathtë të regjionit iJOR (lumbal), grumbullim në lëkuror i ajrit në anën e djathtë të murit të barkut dhe anën e djathtë të regjionit iJOR, grumbullim i ajrit për rreth mëlçisë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit shpues (i mprehtë, me maje) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore dhe të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit. Po ashtu lëndimet e shkaktuara tek i dëmtuari M.Rr., , ku janë konstatuar ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të kokës dhe plagë çarëse-shqyerës të indeve të buta të regjionit të shuplakës së dorës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë, i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, po ashtu lidhur me ekzaminimin e të dëmtuarit D.P., ka konstatuar se tek i njëjti ka ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të fytyrës dhe plagë prerëse-shpuese të indeve të buta të regjionit të kofshës së këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i kombinuar i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë, i topitur)

dhe mjetit prerës-shpues (i mprehtë, me teh dhe maje) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Gjykata ka bërë vlerësimin dhe analizim e mbrojtjes së të akuzuarit A.D., , i cili ka deklaruar se natën kritike kemi dal pas orës 24:00/h me shoqëri tek një lokal me emrin ....., ku aty ka qenë E.. M... ku jemi taku, kam biseduar me M... dhe më tha se jam te libraria G...i, dhe E.. më tha, thuaj se për 10 minuta aty jemi, dhe jemi nis me shkuar menjëherë me F... Sh..., E.. H., M.. O...dhe R.SH., dhe kur shkua aty ka qenë M... me dy të tjerë, të cilët nuk i kam njohur, dhe fillojë me biseduar E.. me M..., ku duke biseduar fillojë me u tensionuar situata dhe ja nisën me u rreh me grushta, dhe mandej ja kemi filluar që të gjithë, ku dy persona kanë pasur thika, po nuk e di saktë se kush kanë qenë, se kam qenë në ndikim të alkoolit dhe njëri ka qenë duke ardhur në drejtim timin dhe më ka shtyrë dikush prej anash dhe jam rrëzuar në tokë, dhe e kam pas një thikë në xhep, dhe duke u mundu me u quar e kam qelë diqysh dhe me dije unë kërkend nuk e kam goditur. Me grushta kam gjuajt, por nuk e di kujt. Kam qenë shumë i dehur pasi që kam pirë në shtëpi, mandej edhe kur kam dal i kam pirë 5-6 birra, nuk kom pas për qëllim me privua dikend nga jeta, e as ta lëndojë dikend, thjeshtë jam munduar me u mbrojte. Nuk e kam dorëzuar thikën, ndoshta më ka ra rrugës duke ik, ku pas ngjarjes kam ndejtë në mëhalle dhe pastaj kam shkuar jam dorëzuar në polici. Nuk ka qenë e imja, thikën ma ka jap në rrugë E.M., , nuk më kujtohet saktë se çfarë ka qenë, nuk ka qenë edhe e madhe, nuk e di që ka qenë e madhe, ne kemi shkuar veç për me fol, e pastaj u tensionua situata dhe pastaj ka filluar përleshja. Kam qenë në ndikim të alkoolit, dhe veç e mora thikën, ka shtuar se nuk pasur qëllim që ta privojë nga jeta askënd, pasi që palën e dëmtuar nuk e kam njohur e as që kam pasur ndonjë konflikt më herët, Gjykata ia ka falur besimin deklarimit të akuzuarit vetëm sa i përket dashjes se i njëjti nuk pasur qëllim që të dëmtuarin F.B., që të provoj nga jeta, ndërsa për pjesën e shkaktimit të lëndimeve nuk ia ka falur besimin.

Gjykata në bazë të prova të cekura më lartë ka vërtetuar këtë gjendje faktikes se i akuzuari A. D.. ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor, kjo vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarëve të lartcekur dhe provave materiale, ku është vërtetuar se konflikti ka ndodhur tel libraria G...ku janë përleshur disa persona ku kanë qenë të ndarë në dy grupe ku i dëmtuari F.B., me të dëmtuarin D.P., kanë qenë afër njëri tjetrit aty janë përdor dy thika, njëren e ka përdoruar F.SH., (i cili ka pranuar fajësinë) i cili ka qenë duke u përleshur me të dëmtuarit M.RR., të cilit i ka shkaktuar lëndime, të cilët kanë qenë në grupin tjetër, ndërsa Gjykata ka vërtetuar se thikën tjetër e ka përdor A.D., i cili ka theruar me thikë këtu të dëmtuarin F.B., dhe D.P., duke iu shkaktuar lëndime si në akt ekspertizën mjeko ligjore, këtë e vërtetojnë edhe të dëmtuarit dhe dëshmitarët të cilët kanë deklaruar se F... ka qenë duke u përleshur me M..., ndërsa A... ka qenë më larg duke u përleshur me F.. B,... dhe D.P., , këtë e ka vërtetuar edhe dëshmitari E.M., i cili ka qenë në vendin e ngjarjes i cili kishte deklaruar se pas rastit A.. i kishte thënë se njërin e ka ther nja 2-3 herë, ku në bazë të lëndimeve i bie të ketë therur . B., po ashtu nga vet deklarimi i të akuzuarit i njëjti ka deklaruar se kam pasur thikë dhe kur jam përleshur e kam nxjerr nga gjepi e kam hapur dhe unë e di se nuk e kam goditur ndonjërin edhe pse ka aloduar se kam qenë i dehur dhe nuk mbaj mend, mirëpo Gjykata ka vërtetuar se në bazë të dëshmive vetëm ky dhe F.SH., kanë pasur thika, ku i akuzuari A.. ka goditur me thikë të dëmtuarin F... dhe të dëmtuarin D.P., (për të dëmtuarin D... në shqyrtimin fillestar kishte pranuar fajësinë), andaj Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A.D., ka kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor ndaj të dëmtuarit F.b., dhe në mungesë të vërtetimit të dashjes për të privuar nga jeta të dëmtuarin F.B., pasi që nuk ka pasur motiv dhe tërë ngjarja ka ndodhur nga një grup të rinjsh të cilët kanë filluar një përleshje fizike pa ndonjë motiv kjo Gjykatë konsideron se nuk ka pasur dashje të privoj nga jeta, andaj në mungesë të dashjes dhe motivit për të kryer veprën penale të vrasjes në tentativë, pra në veprimet e tij ka munguar elementi i dashjes për të kryer veprën penale, ashtu që Gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet e prokurorisë janë të pabazuara dhe një pretendim i tillë nuk mund të

qëndrojë. Gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit av.Musa Damati është i bazuar se në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit nuk është vërtetuar dashja që i akuzuari kishte tentuar ta privon nga jeta të dëmtuarin F.B., , mirëpo duke marr parasysh se i dëmtuari F.B., ka pësuar lëndim të rëndë trupor ashtu që nga ekspertiza mjeko-ligjore nga ekspertja mjeko-ligjor Dr.V.K., , gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti kishte pësuar lëndime të rënda trupore ku ka konstatuar se i njëjti ka marrë plagë prerëse-shpuese të indeve të buta të regjionit të barkut, të regjionit të kafazit të kraharorit, krisje (çarje, plasaritje) traumatike e veshkës së majtë, grumbullim i gjakut në hapësirën në mes të mbështjellësve të mushkërisë së majtë dhe grumbullimi minimal i gjakut në hapësirë në mes të mbështjellësve të mushkërisë së djathtë, gjak mbledhje në parenkimën e veshkës së majtë, gjak mbledhje për rreth veshkës së majtë, gjak mbledhje nën lëkurore në anën e djathtë të murit të barkut dhe në anën e djathtë të regjionit iJOR (lumbal), grumbullim nën lëkuror i ajrit në anën e djathtë të murit të barkut dhe anën e djathtë të regjionit iJOR, grumbullim i ajrit për rreth mëlçisë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit shpues ( i mprehtë, me maje) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore dhe të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit. Prandaj, trupi gjykues në rastin konkret ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së (siç ishte akuzuar nga ana e prokurorisë) në veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së (Kodi i ri nr.06/L-74), pasi që nuk është vërtetuar dashja që i akuzuari kishte tentuar ta privon nga jeta të dëmtuarin F.B., Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i rënd trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së (Kodi i ri nr.06/L-74).

Trupi gjykues, meqenëse nuk e kishte vërtetuar dashjen që i akuzuari kishte tentuar ta privon nga jeta të dëmtuarin F.B., duke u bazuar në nenin 360 par.2 të KPP-së në të cilën është parashikuar se “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, ka vendosur që bëjë ricilësimin e veprës penale nga vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së (siç ishte akuzuar nga ana e prokurorisë) në veprën penale lëndimi i rënd trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, kryesi dënohet me dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, prandaj edhe trupi gjykues e ka ricilësuar veprën penale sipas këtij kodi ashtu që të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së (Kodi i ri nr.06/L-74).

Gjykata nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, pas vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, ka ardhur në përfundim se mund t'i falet besimi mbrojtjes së të akuzuarit dhe mbrojtësit av.Musa Damati, vetëm sa i përket dashjes së të akuzuarit që të dëmtuarin ta provoj nga jeta, ndërsa sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar në tërësi faktin se i akuzuari e ka goditur të dëmtuarin siç është përshkruar në akuzë dhe Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale lëndim i rëndë trupor, mirëpo Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e të akuzuarit - mbrojtësit të tij se nuk e ka goditur të dëmtuarin, janë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe se mbrojtja e tij është në kundërshtim me të gjitha provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor e të cilave gjykata iu ka falur besimin e që janë elaboruar më lartë, por edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit e cila pjesërisht është në kundërshtim edhe me vet deklaratën e tij, pra Gjykata nuk ia fali besimin mbrojtjes së të akuzuarit pasi që mbrojtja e tij është në kundërshtim me provat e dëshmitarëve, i akuzuari ka deklarua se ka pasur thikë, nuk e ka përdor, ka qenë i dehur edhe pse përdorimi i alkoolit edhe pse nuk ka asnjë provë nuk e përjashton përgjegjësinë penale, po ashtu i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet, andaj Gjykata mbrojtjes së të akuzuarit

nuk ia fali besimin, pasi që është në kundërshtim me deklaratimet e të dëmtuarve, dëshmitarit dhe ekspertit dhe provave materiale.

Lidhur me piken e dytë të dispozitiv të këtij aktgjykimi, sa i përket veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, ku i akuzuari A.D., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, ku Gjykata pas marrjes së mendimit të Prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit av.Musa Damati, palëve të dëmtuar, ku janë pajtuar me pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit, Gjykata në shqyrtimin fillestar ia ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit A.D., për shkak të veprës penale lëndim lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi janë plotësuar kushtet për një gjë të tillë, gjykata ka konstatuar se pranimi është bërë në kuptim të dispozitave të KPP-së, i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, po ashtu pas konsultimeve me mbrojtësin e tij avokatin Musa Damati, po ashtu aktakuza mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ndërsa shpalljen e vendimit Gjykata e ka lënë të behët me rastin e vendosjes edhe për pikën I të aktakuzës për të cilin e akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë. Për çka Gjykata edhe për këtë veprë penale ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 5. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari A.D., ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën e I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën e II-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 6. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, trupi gjykues të akuzuarin A. D., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në pikën I të dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, po ashtu veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në pikën e II-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për jeton i vetëm në familje, i pa punë, moshën e tij të re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, po ashtu pranimin e fajësisë për veprën penale lëndim i lehtë truporë në shqyrtimin fillestar, kërkim faljen e shprehur gjate



gjkimit, po ashtu faktin se nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale. Ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin nuk gjeti përveç faktin se në rastin konkret kemi dy të dëmtuar dhe shkallën e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit F.B., . Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto rrethana gjykata ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe se ky dënim si i tilla i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

#### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i Krimeve të Rënda -**  
**PKR.nr.115/20, me datë 08.04.2024**

**Zyrtarja Ligjore,**  
**Gjykatësi**  
**Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor -**  
**Drilon Haraçia**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.